



**DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME  
SPECIJALNA KOMORA VRHOVNOG SUDA**

**C-III.-12-1709**

*Paditës - Propozues:*

**1.F B, 2. H B3.R B dhe 4. Z B, 5. A B** që të gjithë nga f.sh M e E ,K.Fushë Kosovë.  
*Përfaqësuar nga Av.R M K dhe Av.Sh F, Prishtinë*

**Kundër:**

*Të paditura – Pala kundërshtare:*

- 1. Agjencia Kosovare e Privatizimit** , rr. “Dritan Hoxha ” nr. 55, Lakërishtë –Prishtinë,
- 2. N.P V I I sh.p.k**, me pronar F K, Suharekë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës S upreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga gjyqtari Murat Hulaj kryesues, Asllan Krasniqi dhe Bajram Miftari anëtar kolegji, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me datë 07 qershor 2024, lëshon këtë:

**A K T V E N D I M**

1. Kërkesa e paditësve - propozimi për masë të sigurimit, **REFUZOHET** si e pa bazuar.
2. Nuk caktohen taksa gjyqësore.

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me dt.23 tetor 2012, paditësit kanë paraqitur padi – ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës(DHPGJS) kundër të paditurës Agjencisë Kosovare të Privatizimit (APK), me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të aprovoj si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve dhe t’ua njoh të drejtën e pronësisë në ngastrat kadastrale si dhe të obligohet e paditura që t’ua mundësoj regjistrimin pa pengesa në RDP(Regjistrin e të Drejtave Pronësore).

Në padi, ka pohuar se paditësit janë trashëgimtarët e të ndjerit I Sh B, i cili ka vdekur më.., dhe ne si trashëgimtar ligjor jemi pronar të këtyre paluajtshmerivë:

1. Parc.kad.nr..., vendi i quajtur “V”, me kulturë arë, klasa IV, me S= 04.10.34 ha;
2. Parc.kad.nr..., Vendi i quajtur “V” me kulturë arë, klasa IV, me S= 00.66.37 ha;

3. Parc.kad.nr..., Vendi i quajtur “..”, klasa IV, me S= 00.78.96 ha;
4. Parc.kad.nr., Vendi i quajtur “..”, klasa V, me S=02.67.67 ha;
5. Parc.kad.nr., Vendi i quajtur “...”, klasa V, me S= 00.51.17 ha, të gjitha këto në ZK D e E në sipërfaqe të përgjithshme SP=0 8.74.51 ha.

Por pas një kontesti me dy parcelat e para, pasi që është lajmëruar pronari i tyre, Kombinati Bujqësor me dt.29.12.1994, na ka ofruar marrëveshje që në vend të këtyre dy parcelave kontestuese të na japin tri parcela tjera:

1. Parc.kad.nr., klasa IV, me S= 01.98.40ha;
2. Parc.kad.nr., klasa IV, me S= 01.78.22ha;
3. Parc.kad.nr., klasa IV, me S= 01.00.09ha.

Me vendimin e Këshillit Ekzekutiv të Komunës së Fushë Kosovës, është sjellë vendimi për kthimin e paluajtshmerisë, kurse ne me vendimin e Gjykatës Komunale Prishtinë – Dega Graçanicë, jemi shpallur trashëgimtar ligjor të I B. Pasi që e kemi marr vendimin për kthimin e paluajtshmerisë e kemi marr të njëjtën në posedim. Pas luftës e kemi njoftuar komunën se prona është kthyer nga KBI. Në rrugë jo zyrtare kemi marr informata se kjo pronë është shitur nga AKP, dhe i jam drejtuar me shkresë AKM. Padisë i kanë bashkangjitur këto prova: Aktvendim 04.nr.464-744/91 dt.01.09.1992, Aktvendim nr.176 dt.03.05.2012, Aktvendimi i Gjykatës Komunale Prishtinë – Dega Graçanicë O.br.779/11 dt.26.03.2012, Marrëveshje për shkëmbimin dhe pasurinë e paluajtshme të tokës nr. dt..., Njoftim për ngritjen e padisë dt.05.06.2012, Kërkesë për anulimin e shitblerjes së pronës dt.03.04.2012.

Përsëri me dt.31.12.2020 paditësit i janë drejtuar gjykatës, ku përmes padisë kanë kërkuar që të vërtetohet se paditësit janë pronar të 1. parc.kad.nr., klasa IV, me sipërfaqe prej 1.98.40ha; 2.parc.kad.nr., klasa IV, me sipërfaqe prej 1.78.22ha; 3.parc.kad.nr., klasa IV, me sipërfaqe prej 1.00.09ha të që gjitha ZK D e E.

E paditura AKP me dt.22.09.2021, i është drejtuar gjykatës me përgjigje në padi, ku ka pohuar se, e kundërshtojnë në tërësi padinë dhe pretendimet e paditësve pasi që AKP, nuk posedon asnjë pronë të patundshme rreth të cilës ***detyrohet të deklarohet lidhur me pronat kontestuese. Padia është paraqitur në kundërshtim me legjitimitetin pasiv.*** Nuk ka mbështetje ligjore se prona është në posedim të paditësve dhe se janë në posedim faktik dhe disponojnë në mënyrë të pa penguar dhe ky pretendim i paditësve është në kundërshtim me nenin 29 të LMTHPJ. Sa i përket vendimit administrativ për kthim të tokës, pronarët duhej ta kishin realizuar në rrugë administrative dhe jo gjyqësore, dhe se kërkesa për ta ekzekutuar është parashkruar konform nenit 361 të LMD ose 379 të LMD-së së viti 1978. Kontrata e ndërrimit e vitit 1994, nuk mund të merret për bazë pasi që nuk është valide. Sa i përket Aktvendim 04.nr.464-744/91 dt.01.09.1992, DHPGJS ka konstatuar se nuk ka juridiksion për ekzekutim. Sipas fletës poseduese të dt., ngastrat kadastrale AKP nuk i ka tjetërsuar për shkak të kontesteve që janë qenë të iniciuara më herët, kurse sipas Certifikatës së pronës nr.. dt., disa nga këto ngastra janë të pa realizuara pasi që gjenden në pronësi të personave të tretë, kështu që AKP i mungon legjitimiteti pasiv. Ka kërkuar që të refuzohet kërkesëpadia e paditësve. Përgjigjes i ka bashkangjitur: Certifikata e pronësisë nr. dt..

Gjykata me dt.27.10.2022, iu ka drejtuar paditësve me urdhër duke i kërkuar vendimin e Komisionit për kthimin e pronës nr.. dt., si dhe marrëveshjen për këmbimin e pasurisë së

paluajtshme nr. dt... Urdhri është tentuar që ti dorëzohet të autorizuarit të ankuesve Av. M D, por nuk ka mundur që ti dorëzohet.

Me dt.27.10.2022, gjykata i është drejtuar Komunës së Fushë Kosovës – Drejtorisë për Kadastër, nga e cila ka kërkuar të dhëna lidhur me historiatin e ngastrave nr., si dhe .ZK D e E Komuna Fushë Kosovë. E njëjta i është përgjigjur gjykatës me dt.17.11.2022, ku ka theksuar se ngastrat kadastrale nr. si.. dhe., kanë si posedues: N.P V. I.I. sh.p.k, parcela është bartur nga P.SH “KBI Kosova – Export D.S “Kosovo Eksport” në vitin 2014. Ngastrat janë të vendosura në Masë të Sigurisë sipas lëndës C.nr. dt.07.10.2019 nga Gjykata Themelore si dhe këto ngastra janë në Hipotekë. Kurse ngastra kadastrale nr. ka pronar P.SH “KBI Kosova – Export D.S PIK Kosova Eksport”. Së bashku me parashtrësë e ka dorëzuar Certifikatën dt. për parc.kad.nr., për parc.kad.nr. si dhe për parc.kad.nr., të gjitha këto së bashku me kopjen e planit.

Gjykata përsëri me dt.03.08.2023, ka kërkuar nga të autorizuarit e paditësve që të bëjnë dorëzimin e Vendimit të Komisionit për kthimin e pronës nr.. dt.. si dhe marrëveshjen për këmbimin e pasurisë së paluajtshme nr.. dt... Të autorizuarit e ankuesve i janë përgjigjur gjykatës përmes parashtrësës së dt.15.08.2023, duke i sjellë këto prova, si dhe kanë sqaruar se është bërë një gabim teknik pasi që në vend që të shkruhet nr. nr.464-744/91 dt.01.09.1992, është shkruar nr.464-764/91 dt.01.09.1992.

Me datë 16 maj 2024, të autorizuarit e paditësve kanë paraqitur Propozim për Caktimin e Masës së Sigurisë, me anë të së cilës kanë kërkuar që ti ndalohej N.P V I I SH.P.K me nr. të biznesit .., me pronar - aksionar F K, ta tjetërsojnë, fshehin, ngarkojë apo disponojë me pronën e paluajtshme P-, P-, P-, P-, të gjitha në ZK. Fushë Kosovë – M e E.

Ka pohuar se këto prona figurojnë në emër të N.P V I I SH.P.K me nr. të biznesit.., me pronar - aksionar F K dhe të njëjtat figurojnë se janë hipotekë e kredisë në Bankën Kombëtare Tregtare –BKT. Ka shtuar se janë plotësuar të dy kushtet e parapara me nenin 297 par.1 të LPK-së, pasi që në bazë të provave është e pa kontestueshme që parashtruesit e kërkesës janë pronar faktikë, të njëjste kadastrale nr., nr.. nr., nr.. të gjitha në ZK M e E, dhe meqenëse ndodhen në hipotekë ekziston rreziku se mund të kalojnë në posedim të personit të tretë.

E paditura - kundër propozuesja e parë AKP, me dt.27 maj 2024, ka paraqitur përgjigjen e saj, në kërkesën për caktimin e masës së sigurisë, ku ka pohuar se: e kundërshton propozimin për caktimin e masës së sigurisë në ngastrat e theksuara, pasi që nuk është i mbështetur në prova relevante dhe të besueshme. Aktvendimi nr.464-764/91 dt.01.09.1992, si dhe vendimi për konfiskim nuk janë provë e besueshme. Është e nevojshme të ftohet dhe Komuna e Fushë Kosovës, për sqarim më të mirë të rastit, dhe pa sqarimin e rastit si ka ndodhur në procedurë administrative, nuk mund të vërtetohet baza për caktimin e masës së sigurisë. Nga viti 2006 këto prona janë shitur dhe kontratat e tilla nuk mund të ndryshohet e as të ndalohej ekzekutimi i tyre. Ka kërkuar që të refuzohet kërkesa për caktimin e masës së sigurisë.

Kundër propozuesja e dytë “V I P” SH.P.K me dt.30 maj 2024 ka paraqitur përgjigjen në padi ku ka theksuar se kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve për shkak se nuk mbështetet në fakte dhe prova konkrete në bazë të të cilave mund të argumentohet baza e padisë dhe e propozimit. Me asnjë provë nuk e kanë vërtetuar fitimin e pronësisë me anë të vendimeve të viteve 1992/94 dhe pretendim se e shfrytëzojnë paluajtshme rinë deri tani. Propozimi për caktimin e masës së sigurisë është i pa bazuar, i pa arsyetuar dhe i pa argumentuar për shkak

se nuk është bërë i besueshëm ekzistimi i të drejtës subjektive. Kundër propozuesit e masës nuk kanë kurrfarë obligimi pasi që të njëjtit i kanë këto prona në bazë të drejtës së qira mbajtjes për 99 vite, nga ish NSH “Lavërtari – Blegtori”. Ka kërkuar që të refuzohet kërkesa për caktimin e masës së sigurisë.

### **Arsyetimi Ligjor**

#### **Kërkesa për masë të sigurimit është e pabazuar.**

Sipas nenit 61 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, Dhoma e Posaçme mund të nxjerr një masë të sigurimit me kusht që parashtruesi të ofrojë prova të besueshme se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të pariparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e sigurimit. Dëmi konsiderohet si i pariparueshëm vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar.

Paditësi i cila kërkon urdhër paraprak gjyqësor duhet të dorëzoj dëshmi të besueshme se:

1. ekziston e drejta, dhe
2. kjo e drejtë mund të dëmtohet në mënyrë të pariparueshme nëse nuk miratohet masa e sigurimit.

Barra e provës është tek paditësit, kështu që paditësit përveç që duhet të ofroj dëshmi të besueshme se e drejta e rrezikuar ekziston, duhet të ofrojë dëshmi dhe ta bëjë të besueshme faktin se do të shkaktohet dëm i menjëhershëm dhe i pariparueshëm, nëse nuk aprovohet kërkesa për masë të sigurimit.

#### **Ekzistimi i së drejtës së pretenduar**

Pa paragjykuar zgjidhjen përfundimtare të këtij kontesti, Kolegji vlerëson se paditësit në këtë fazë të procedurës, nuk kanë dorëzuar dëshmi të besueshme se ekziston e drejta e pretenduar në favorin e tyre. Pretendimet e paditësve se pronën kontestuese e kanë fituar në bazë të vendimit me nr.464-764/91 dt.01.09.1992 të Këshillit Ekzekutiv të Komunës së Fushë Kosovës nuk mund të merret si provë për caktimin e masës së sigurisë. Mbi bazën e këtij vendimi nuk mund të konstatohet ekzistimi i të drejtës së saj të pretenduar. Aq më pak kur në certifikatës së pronësisë si posedues – pronar të parcelave kadastrale figuron N.P V I I SH.P.K.

#### **Dëmi i menjëhershëm**

Gjykata vlerëson se nuk është plotësuar as kushti për dëm të menjëhershëm për caktimin e Masës së sigurimit, pasi që paditësit nuk e ka paraqitur ndonjë rrethanë, nga e cila pritet të pësojë ndonjë dëm të menjëhershëm dhe se nuk ka dorëzuar dëshmi të besueshme se kjo e drejtë mund të dëmtohet menjëherë, nëse nuk miratohet kërkesa për masë të sigurimit.

#### **Dëmi i pariparueshëm**

Sipas dispozitave ligjore dëmi konsiderohet si i “pariparueshëm” vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar. Në rastin konkret, as kushti për dëm të pariparueshëm, si kusht për tu caktuar masa e sigurimit nuk është plotësuar.

Në këtë rast gjykata, nuk ka gjetur se kërkesa e paditësit për Masë të Sigurimit, mund të ketë mbështetje në dispozitën e nenit 61 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, prandaj kërkesa si e tillë u refuzua si e pa bazë.

### **Shpenzimet Gjyqësore**

Paditësi tani më ka paguar taksen gjyqësore për kërkesën për masë të sigurimit në shumë prej 100.00 Euro me datë 20.05.2024 dhe nuk ngarkohet me taksa shtesë.

### **Këshillë Juridike:**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme Brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

**1. Murat Hulaj, Gjyqtar kryesues** \_\_\_\_\_

**2. Asllan Krasniqi, Gjyqtar** \_\_\_\_\_

**3. Bajram Miftari, Gjyqtar** \_\_\_\_\_